Lezhë, më 19.04.2022

# PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në dt. 19.04.2022, në orën 13:00, në Sallën e Qendrës Kulturore të Fëmijëve (QKF), mbi mbledhjen jashtë radhe, të kërkuar nga Kryetari i Bashkisë, pasi për shkak të procesit të rindërtimit, afatet e parashikuara nuk presin dot mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak.

Mbledhja u hap nga Kryetari i KB Lezhë, z. Ernest Rakaj, i cili lexoi rendin e ditës, të njoftuar më parë.

Z. Rakaj hodhi në votim rendin e ditës, që u miratua nga të gjithë këshilltarët prezentë, përveç z. Agostin Marku që nuk votoi.

→ Erdhi zj. Jorida Mikaj.

Kryetari z. Ernest Rakaj filloi me pikën 1 të rendit të ditës që është projekt vendim "Për përcaktimin e strukturës së banimit për subjektet përfituese në ndërtesën (Pallat), të rindërtuar pas "Tërmetit të 26 Nëntorit" në lagjen "Skënderbej"" dhe i dha fjalën zv/kryetarit të Bashkisë, z. Ermal Pacaj, i cili dha shpjegime për projekt vendimin sipas relacionit përkatës.

U diskutua nga këshilltarët Emiljan Lazri, Marte Simoni dhe Marin Suta rreth disa problematikave të rindërtimit, në lidhje me shtëpitë e padëmshpërndara në pallatin e ri te lagjja Besëlidhja, pallatin te BKT dhe pallate

të dëmtuara në loggjen Skënderbej.
ZV/Kryetari i Bashkisë z. Ermal Pacaj dha shpjegime, ku ndër të tjera tha se shorti për pjesën e mbetur të shtëpive do hidhet për të gjithë bashkinë por, në pallatin "Besëlidhja" ka pasur problemi që disa familje nuk kanë aplikuar në asnjë nga fazat dhe shorti pritet që të hidhet për të gjithë bashkinë, si për ata që kanë aplikuar në fazën e dytë, si për ata që nuk kishin aplikuar fare që janë të evidentuar. Sa i përket pallatit te BKT, do shkojë paralel rindërtimi i seksionit të parë me përforcimin e seksionit të dytë. Ndërsa për rastin te loggjia Skënderbej që pyeti Marin Suka për të cilin tha që ka 30 vite që e ka blerë shtëpinë dhe nuk është përfitues, z. Pacaj tha që di që ai person nuk ka asnjë lidhje me atë shtëpi, as edhe sikur një faturë dritash apo faturë uji. Me certifikatë pronësie, vetëm 3 familje janë. Ai person mund edhe ta apelojë. Aty janë 3 apartamente që janë rezervë që ne i kemi lënë pikërisht për këto raste që janë familje që ne nuk kemi ku të kapemi ligjërisht. Por atyre mund t'u jepet nga Bashkia si të pastrehë dhe të mbetet pronë e bashkisë. Pra, ata fituesit do hyjnë në shtëpi të re.

Ernest Rokaj: Meqë nuk ka dikush tjetër pyetje, e kalojmë projekt vendimin në votim.
U miratua nga të gjithë këshilltarët prezent, përveç z. Agostin Marku që nuk votoi.
Kalojmë te pika 2 e rendit të ditës që është projekt vendim "Për një shtesë në Buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2022 dhe PBA-në 2022-2024" dhe i jap fjalën z. Pacaj i cili do japë shpjegime për p/vendimin sipas relacionit përkatës.

→ Këshilltari Redi Brunga pyet për pallatet te Vendvorrimi i Skënderbeut.

Ermal Pacaj: Janë disa pallate aty të cilët janë për përforcim dhe për ambiente të përbashkëta por do vazhdohet me radhë. Po punohet njëherë aty ku ka më nevojë. dmth është ndërhyrë te pallatet që kanë patur shkallë dëmtimi DS4. Jemi brenda kontratës sa i përket pjesës së përforcimeve.

Ernest Rokaj: Meqë nuk ka pyetje të tjera, e kalojmë projekt vendimin në votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezent, përveç z. Agostin Marku që nuk votoi.
Kalojmë te pika 3 e rendit të ditës, që është projekt vendim "Për një ndryshim në VKB nr. 177, dt. 23.12.2021 "Për miratimin e buxhetit për vitin 2022 dhe PBA-në

2022 - 2024 dhe përdorim të fondit të kontigjencës" dhe i jep fjalën z. E. Pacaj i cili do japë shpjegime për pj vendimin sipas relacionit përkatës.

→ Erdhi z. Rigels Nicaj.

Ernest Rakaj: Ka kush pyetje?

Po Agostin.

Agostin Marku: Unë më shumë e kam merakun kur miratohet buxheti në fillim të vitit dhe vërejtja ime kryesore kjo ka qenë, që nuk po e bëni të studjuar sepse po të ishte bërë i studjuar nuk do kishte kaq shumë ndryshime. Edhe sot je i vonuar për këtë, me prokurime e procedura.

Ernest Rakaj: E hedhim projekt vendimin në votim.

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë, përveç z. Agostin Marku që votoi kundër.

Ju faleminderoj.

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

| | |
|---|---|
| SEKRETARI | KRYETARI |
| FLORIDA GJONAJ | Ernest Rakaj |